20/2022

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

PËRFSHIRJA E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË VENDIMMARRJE

ANALIZË E NEVOJAVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN PËRMES TAKIMEVE TË HAPURA NË KOMUNAT: PRISHTINË, PRIZREN, PEJË, GJAKOVË, OBILIQ, FERIZAJ, GJILAN, FUSHË KOSOVË DHE KAMENICË.

15 dhjetor 2022

Autorë: Gzim Shala, Arrita Rezniqi, Lavdim Makshana, Shqiponjë Gashi, Blerim Jakupi, Medina Kadriu, Driton Noci

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Naim Jakaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Danish Refugee Council (DRC).

Përkrahur nga:

DRC DANISH REFUGEE COUNCIL

Financuar nga:

Sweden Sverige

Implementuar nga:

Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

LISTA E SHKURTESAVE

- **RrSMPKP** Rregullorja Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik
- **PKP** Platforma e Konsultimeve Publike
- **IKD** Instituti i Kosovës për Drejtësi
- **MAPL** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- **KRK** Kuvendi i Republikës së Kosovës
- **QNJ** Qendra për Ndihmë Juridike Falas – IKD
- **QRK** Qeveria e Republikës së Kosovës
- **DADNJK** Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna
- **MD** Ministria e Drejtësisë
- **DKA** Drejtoria Komunale e Arsimit
- **ZKKK** Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
- **MPB** Ministria e Punëve të Brendshme
- **ARC** Agjencia për Regjistrim Civil
- **QKMF** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- **QAP** Qendra e Aftësimit Profesional
- **ZPP** Zyra për Punësim

PËRMBAJTJA

01. Përmbledhje ekzekutive

02. Hyrje

03. Metodologjia

04. Përgjegjësia e autoriteteve publike në pjesëmarrjen publike të qytetarëve

05. Temat e ngritura

06. Gjetjet kryesore

07. Rekomandimet

08. Shtojca – Gjetjet për secilën komunë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti për pjesëmarrjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në procesin e vendimmarrjes është përgatitur si një përpjekje për t'i identifikuar shqetësimet me të cilat përballen këto komunitete në lokalitetet e tyre. Në lidhje me këtë, fokus të rëndësishëm i është kushtuar pjesëmarrjes së tyre në jetën publike përmes konsultimeve publike.

Projekti është realizuar në pajtim me Strategjinë e Institutit të Kosovës për Drejtësi 2021-2025, e miratuar në gusht të vitit 2021 si dhe në bazë të të gjeturave të IKD-së gjatë zbatimit të projektit "Fuqizimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian".

Strategjia e IKD-së, i kushton vëmendje të veçantë forcimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grupeve të margjinalizuara, me fokus tek gratë në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo pasi, të gjeturat e IKD-së gjatë proceseve të ndryshme kërkimore dhe monitoruese dhe raporteve të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, tregojnë se:

- Duhet bërë më shumë për garantimin e të drejtave të grupeve të margjinalizuara;
- Pjesëtarët e këtyre komuniteteve përballen me qasje të kufizuar në ujë të pastër dhe kanalizime, pajisje mbrojtëse dhe kujdes shëndetësor, ndërsa qasja në arsim dhe punësim formal mbetet e vështirë;
- Niveli i punësimit të këtyre komuniteteve në institucionet shtetërore mbetet i ulët dhe kryesisht në nivelet e ulëta të punësimit;
- Strategjia 2021-2027 për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, është zbatuar vetëm pjesërisht;
- Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ballafaqohen me probleme pronësore;
- Shumë pjesëtarë të këtyre komuniteteve nuk janë të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, gjë që e bën të pamundur ushtrimin e të drejtave të tyre themelore si qasja në arsim, shëndetësi, drejtësi, etj;
- Sa i përket pabarazive shëndetësore, gjendja e komuniteteve rom dhe ashkali mbetet shqetësuese, duke pasur parasysh nivelet shumë të ulëta të imunizimit dhe vështirësitë e veçanta në qasjen në kujdesin shëndetësor për shkak të kushteve të tyre të vështira socio-ekonomike;
- Sfidë mbetet edhe shpërndarja e informacionit për shërbimet publike, rastet e diskriminimit, etj;
- Pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në politikëbërje dhe vendimmarrje është në nivel shumë të ulët;
- Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përballen me vështirësi në qasjen në drejtësi për shkak të mungesës së njohurive për të drejtat e tyre, vështirësive socio-ekonomike, etj.

Takimet informuese dhe trajnuese u realizuan gjatë vitit 2022, takime të cilat u zhvilluan në Fushë-Kosovë, Prishtinë, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Obiliq, Kamenicë dhe Prizren. Në këto takime, ishin të përfshirë 128 anëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, prej të cilëve 15 qytetarë kanë përfituar nga trajnimi për Rregulloren për Standardet Minimale për Konsultimin Publik, si dhe u përfshinë drejtpërdrejt në proceset e konsultimit publik, 30 qytetarë kanë përfituar nga shërbimet e këshillimit juridik falas.

Sipas të dhënave të mbledhura nga IKD, rezulton se në takimet informuese dhe trajnuese kanë marrë pjesë: 28 gra dhe 100 burra, prej tyre 60 qytetarë rom, 39 ashkali, 26 egjiptianë, dy serbë dhe një shqiptar.

Rezultatet e raportit janë të përmbledhura dhe sistemuara në pjesën e katërt të raportit, kurse raporti për secilin takim është radhitur në pjesën e gjashtë të këtij raporti.

Hyrja paraqet arsyen e studimit, qëllimin dhe objektivat e studimit, fushat kryesore ku IKD është fokusuar në takimet informuese dhe trajnuese. Më tutje, është shpjeguar metodologjia e zbatuar.

Raporti vazhdon me spjegimin mbi bazën kushtetuese dhe ligjore për atë se kush është përgjegjës kryesor për (mos) suksesin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimeve publike.

Pjesa e dytë dhe e tretë paraqet temat e ngritura nga ana e trajnerëve të IKD-së, si dhe nevojat e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve për pjesëmarrje efektive në politikëbërje - gjetjet kryesore të përmbledhura në format të infografikës.

Pjesa e tretë dhe e fundit e raportit, përfshinë në pika të shkurtra secilin takim të mbajtur në komunat përkatëse.

Raporti është hartuar me qëllimin që të tregojë mungesën e pjesëmarrjes së qytetarëve rom, ashkali dhe egjiptian në procesin e vendimmarrjes publike. Mbi këtë arsye, raporti do të shërbejë edhe për qëllime të cilat institucionet qendrore dhe lokale, gjetjet t'i marrin parasysh dhe të nisin së zbatuari në përpikëri obligimet që dalin nga Rregullorja për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimeve Publike.

HYRJE

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe në bërjen e ligjit vazhdon të jetë e ulët në nivel kombëtar. Këtë e dëshmojnë vazhdimisht raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe statistikat e Raporteve Vjetore për Konsultimin Publik. Kjo pjesëmarrje e ulët ndikon që ligjet dhe politikat në vend të mos marrin parasysh nevojat reale të qytetarëve të vendit, aq më pak ato të grupeve të margjinalizuara ku pjesëmarrja është edhe më e ulët, në këtë rast të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Raportit vjetor i vitit 2021 për konsultimet publike në Qeverinë e Kosovës të publikuar në Platformën e Konsultimeve Publike, tregon se gjatë vitit 2021 janë hartuar 220 dokumente, prej të cilave 156 prej tyre ose 69,6% dhe 68 dokumente ose 30,4% prej tyre nuk i plotësojnë standardet minimale për konsultime me publikun.[1] Sipas këtij raporti, pjesëmarrja e përgjithshme në konsultimet publike ka arritur në 2285 pjesëmarrës me 1898 komente, të cilat kanë përfshirë marrjen e komenteve përmes përmes platformës, takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim.

Pjesëmarrje e ulët në konsultimet publike vlerësohet të jetë ajo përmes platformës online. Nga 220 dokumentet e publikuara janë komentuar vetëm 47, me vetëm 73 komente

Mbi këto arsye, Instituti i Kosovës për Drejtësi ka konsideruar se është e nevojshme të zhvillohen takime informuese dhe trajnuese për të treguar së pari mbi rregullativën që mundëson pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe së dyti, se si kjo pjesëmarrje të realizohet në praktikë.

IKD, po ashtu e ka parë të domosdoshme ndihmesën në ndërtimin e njohurive të Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimeve Publike. Kjo rregullore ka për synim dhe qëllim promovimin dhe sigurimin e një procesi të konsultimit publik ndërmjet autoriteteve publike, palëve të interesuara dhe publikut, për një proces gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes në politikëbërje dhe vendimmarrje me interes publik dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe të publikut.

Rregullorja përcakton standardet minimale, parimet dhe procedurat e procesit të konsultimit publik ndërmjet autoriteteve publike, palëve të interesuara dhe publikut në procesin e hartimit të politikës dhe legjislacionit. Me fjalë të tjera, rregullon procesin e konsultimit publik, që është: pjesëmarrja e palëve të interesuara dhe publikut në vendimmarrjen e organeve publike, me njoftimin e bërë nga organi publik përgjegjës.

[1] Raportit vjetor 2021 për konsultimet publike në Qeverinë e Kosovës, 2021, i qasshëm nga: https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-62bab5fb93501.pdf

IKD, përmes këtij projekti i ka kushtuar rëndësi të veçantë forcimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grupeve të margjinalizuara, me fokus te gratë dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo pasi gjetjet e IKD-së gjatë proceseve të ndryshme kërkimore dhe monitoruese dhe raporteve të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, tregojnë se nevojiten më shumë aktivitete për të mundësuar dhe garantuar të drejtat e grupeve të margjinalizuara, pjesëtarët e këtyre komuniteteve përballen me qasje të kufizuar në ujë të pastër dhe kanalizime, pajisje mbrojtëse dhe kujdes shëndetësor, ndërsa qasja në arsim dhe punësim formal mbetet e vështirë. Më tutje, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, përballen me nivel të ulët të punësimit në institucionet shtetërore.

Strategjia 2021-2027 për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, është zbatuar vetëm pjesërisht. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ballafaqohen me probleme pronësore dhe shumë qytetarë vazhdojnë të jenë të paregjistruar në Gjendjen Civile, gjë që iu shkakton dhe ua bën të pamundur ushtrimin e të drejtave të tyre themelore, si qasja në arsim, shëndetësi, drejtësi, etj.

01. METODOLOGJIA

Instituti i Kosovës për Drejtësi, në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të projektit, ka planifikuar të përdorë dy metoda: **a) përmes takimeve informuese dhe trajnuese për rëndësinë dhe mundësinë e pjejëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes publike,** si dhe **b) demonstrimit të kësaj pjesëmarrjeje në konsultimet me shkrim në Platformën Online të Konsultimeve Publike.**

02. TAKIME INFORMUESE DHE TRAJNUESE

IKD, ka mbajtur takime informuese dhe trajnuese në shtatë (7) rajonet kryesore të Kosovës, në mënyrë që t'i identifikojë nevojat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në secilin takim me pjesëtarë të këtyre komuniteteve, është synuar që të ketë pjesëmarje prej 15 qytetarëve, e në total rreth 105 pjesëmarrës. Qëllimi i këtyre takimeve, është informimi dhe trajnimi se si duhet të monitorojnë nëse kërkesat e tyre përfshihen në procesin e ligjbërjes dhe se si të avokojnë më tej që përfshirja e tyre të jetë efektive. Takimi informues dhe trajnues është publikuar në faqen zyrtare të IKD-së dhe në mediat sociale.

03. DEMONSTRIMI I PJESËMARRJES NË KONSULTIMET ME SHKRIM

Për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në procesin e politikëbërjes dhe në procesin e vendimmarjes, trajnerët e IKD-së kanë demonstruar mënyrat e konsultimit me shkrim, veçanërisht se si IKD i ka shkruar dhe dërguar komentet për njërin ndër Projektligjet më të rëndësishme të administratës publike në Kosovë, atë të Projektligjit për pagat në sektorin publik. Kështu, pjesëmarrësit e disa prej takimeve kanë pasur mundësi që në mënyrë praktike të informohen me gjithë procedurën e hartimit të një komenti dhe dërgimit të tij.

Si rezultat, IKD do të trajnojë 15 qytetarë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për standardet minimale të konsultimit publik, dhe do t'i përfshijë ata në katër (4) konsultime publike lidhur me miratimin e politikave në nivel qendror apo lokal. Një trajnim, me kohëzgjatje prej një dite, do të zhvillohet në Prishtinë.

Po ashtu, 30 qytetarë do të përfitojnë nga shërbimet e këshillimit juridik falas dhe 30 përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve dhe mediave, do të marrin pjesë në një tryezë të rrumbullakët.

04. ZBATIMI NË PRAKTIKË I KONSULTIMIT PUBLIK NGA NENI 7 I RREGULLORES PËR STANDARDET MINIMALE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Procesi i përfshirjes së qytetarëve rom, ashkali dhe egjiptian, në konsultime publike do të kryhet duke marrë pjesë nëpërmjet një prej formularëve të konsultimit publik të përcaktuar në nenin 7 të rregullores. Disa nga format e konsultimit publik, janë: konsultimi me shkrim dhe elektronik; publikimi në faqen e internetit; takime publike; konferenca, etj. Në këtë mënyrë, zhvillimi i këtij aktiviteti, do të forcojë kapacitetet brenda komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të inkurajuar dhe rritur pjesëmarrjen aktive të këtyre komuniteteve në ligjbërje dhe politikëbërje.

PËRGJEGJËSIA E AUTORITETEVE PUBLIKE NË PJESËMARRJEN PUBLIKE TË QYTETARËVE

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës, institucionet publike të Kosovës obligohen që t'i informojnë qytetarët dhe të gjitha palët e interesuara për punën dhe dokumentet që ato i prodhojnë. Kjo e drejtë është shumë e rëndësishme, e cila ia mundëson secilit person të shfrytëzojë qasjen e lejuar në të gjitha dokumentet publike, të cilat organi publik i caktuar i posedon.[1] Në pajtim me nenin 41- E drejta e qasjes në dokumente publike, këto dokumente duhet të jenë transparente, rrjedhimisht publike. Përjashtimisht nga këto dokumente, janë ato që janë të klasifikuara me ligjin përkatës – shikimi dhe posedimi i të cilave është i kufizuar.

Ushtrimi në praktikë, i të drejtës së qasjes në dokumente publike realizohet përmes Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike[2], qëllimi i të cilit është garantimi i të drejtës së secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të prodhuara, pranuara, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve të sektorit publik. Ligji si i tillë, zbatohet për secilin dokument publik që prodhohet, pranohet, mbahet apo kontrollohet nga institucionet publike, përveç në rastet kur përcaktohet ndryshe me legjislacionin në fuqi, në Kosovë.

Në pajtim me Kushtetutën, respektivisht Neni 45, paragrafi 3 *"Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike"*. Në këtë drejtim, kjo pjesëmarrje duhet të realizohet në mënyrë efektive për të gjithë palët e interesuara, qytetarët dhe grupet e caktuara shoqërore. Kësisoj, mundësohet pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve në aktivitetet publike dhe e drejta e tyre për të ndikuar në vendimet e organeve publike.

Për ta forcuar më tej këtë të drejtë dhe për ta formalizuar e thjeshtëzuar, Qeveria e Kosovës në vitin 2016 miratoi Rregulloren për Standardet minimale për procesin e konsultimit publik, e cila shprehimisht thotë se nisma për konsultime gjithmonë duhet të vijë nga autoritetet publike dhe ato e bartin barrën dhe përgjegjësinë kryesore për (mos) suksesin e këtij procesi.

Sipas Rregullores, qëllimi i saj është që të nxisë dhe të sigurojë procesin e konsultimit publik ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes publik, si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe publikut.

[1] Neni 41 i Kushtetutës, E drejta e qasjes në dokumente publike

[2] Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, i qasshëm nga: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20505

Rregullorja ka përcaktuar edhe standardet minimale, parimet dhe procedurat në procesin e konsultimit publik, ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut, në procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit (Neni 1, paragrafi 2 i Rregullores).

Për nevoja të këtij raporti, do të trajtohen tri çështje kryesore: cilat dokumente i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, format dhe teknikat e konsultimeve dhe mënyrës së identifikimit të palëve që do të duhej të ishin subjekt i pjesëmarrjes në procesin e konsultimeve.

Me shfrytëzimin e të drejtës së pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik, arrihet qëllimi përmes së cilit diskutohen dhe adresohen vërejtjet dhe komentet e palëve të interesit. Por, për t'u arritur ky aspekt i rëndësishëm i pjesëmarrjes, organi publik iniciues i dokumentit, duhet që të ndërmarrë hapa për t'i identifikuar palët e interesit. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nuk mund të diskutohet e të mos përfshihen përmes procesit të identifikimit të komuniteteve që i prekin direkt ato. Andaj, me Rregulloren për standardet minimale në procesin e konsultimit publik, respektivisht Neni 12, është obliguar Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Qeverisë, që të krijojë dhe të mirëmbajë një Platformë online, të cilin e shfrytëzojnë të gjitha organet publike për të identifikuar hisedarët për zhvillimin e konsultimit me publikun.

Për shkak të rëndësisë që kanë dokumentet që do të miratohen, të cilat në fazat e tjera të mëvonshme do të ndikojnë në jetën e qytetarëve, ato publikohen në Platformën e Konsultimeve Publike për t'u komentuar nga secili qytetar dhe nga çdo palë e interesuar. Në këtë drejtim, kjo e drejtë zbatohet në tërësi për dokumentet themelore që i përgatisin organet publike. Sipas Rregullores për standardet minimale, dokumentet që i nënshtrohen procesit të konsultimeve publike, janë: Projekt-plani vjetor i dokumenteve strategjike, projekt-programi legjislativ i Qeverisë, projekt-plani i akteve nënligjore, projekt-lista e koncept-dokumenteve, projekt-koncept dokumentet, projekt-aktet normative, projekt-strategjitë si dhe të gjitha dokumentet tjera, të cilat duhet të shoqërohen me memorandum shpjegues, apo për të cilat kërkohet konsultimi me publikun.

Pjesëmarrës TOTAL	Gra	Burra
128	28	100

	1	2	3	4	5
	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Kamenicë	Fushë Kosovë
Numri i pjesëmarrësve	17	10	14	17	16
Gra	2	2	1	3	1
Burra	15	8	13	14	15
Rom	1	1	13	17	2
Ashkali	16	0	1	0	5
Egjiptian	0	9	0	0	9

Pjesëmarrës TOTAL	Gra	Burra
128	28	100

	1	2	3	4	5
	Obiliq	Pejë 1	Pejë 2	Prizren	Prishtinë
Numri i pjesëmarrësve	13	6	10	11	14
Gra	4	0	6	3	6
Burra	9	6	4	8	8
Rom	10	1	3	8	4
Ashkali	0	0	0	2	6
Egjiptian	0	5	7	1	4
Serb	2				
Shqiptar	1				

TEMAT E TRAJTUARA

01 Procesi i politikbërjes në Kosovë

02 Procesi i inicimit të hartimit të ligjeve dhe miratimit të tyre

03 Rregullorja mbi Standardet Minimale të Konsultimit Publik

04 Demonstrimi i punës së Platformës Online të Konsultimeve Publike

05 Ligji për Qasje në Dokumente Publike

06 Roli i Agjencisë për Informim dhe Privatësi

07 Ofrimi i Ndihmës Juridike Falas nga QNJ

08 Trajtimi i rasteve të dhunës në familje në Platformën Online për Ndihmë Juridike Falas

GJETJET KRYESORE

Nivel i ulët i punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian – kuotimi për punësim vazhdon të mosrespektohet nga organet publike lokale dhe qendrore

Infrastruktura në lokalitetet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbetet e dobët. Probleme të shumta për shkak të mungesës së ndriçimit publik dhe aty ku ekziston, është ndriçim i dobët. Më tutje, këto komunitete vazhdojnë të përballen me rrugë të dobëta, pa kanalizim adekuat dhe me deponi të mbeturinave afër venbanimeve.

Kërkesat dhe ankesat e këtyre komuniteteve nuk shqyrtohen nga organet komunale. Edhe kur shqyrtohen, përgjigja e organeve ndaj tyre është me vonesë të theksuar kohore.

Diskriminim dhe pamundësi e shkollimit të fëmijëve të tyre nëpër shkollat publike. Mungesë e theksuar e pajisjeve dhe materialeve për të vijuar mësimin.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, vazhdojnë të jenë grupi më pak i përfshirë në arsimin fillor. Për më tepër, shqetësues mbetet niveli i ulët i ndjekjes së shkollimit deri në fund.

Regjistrimi civil i qytetarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mbetet njëri ndër problemet esenciale. Ata nuk kanë dokumentacion të nevojshëm personal, gjë që ua pamundëson marrjen e ndihmave sociale, për çka ata i plotësojnë kushtet e tjera.

Qasja në institucionet e drejtësisë vazhdon të mbetet problematike, ngase trajtimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, sipas tyre vazhdon të jetë i ndryshëm nga palët e tjera.

Problematikë e theksuar në raport me qasjen në drejtësi vazhdon të jetë vonesa në zgjidhjen e lëndëve, veçanërisht tek nënat vetushqyese, të cilat pa vendim të gjykatës për besim të fëmijëve, nuk arrijnë ta rregullojnë çështjen e ndihmës sociale.

Legalizimi i pronave mbetet një problem i trashëguar. Pjesëtarë të këtyre komuniteteve, vazhdojnë të përballen me pamundësinë e regjistrimit të pronave në emër të tyre, përkundër faktit që ato u takojnë gjeneratë pas gjenerate.

Ankesa në lidhje me procedimin e rasteve të tyre kur ato raportohen në polici, prokurori etj. Sipas tyre, ata diskriminohen si komunitet dhe nuk marrin përgjigje nga këto organe, ashtu siç u takon me ligj.

REKOMANDIMET

PASOJAT E MOS-REGJISTRIMIT NË GJENDJEN CIVILE

Mungesa e regjistrimit civil, bart pasoja të mëdha sa i përket shfrytëzimit të të drejtave që i garanton Kushtetuta e Kosovës dhe legjislacioni specifik për secilin qytetar të Kosovës, veçanërisht për grupet e cenueshme, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Pasojat shtrihen në të drejtën e qasjes në arsim, punësim, gëzimit të skemave sociale dhe të drejtës për të udhëtuar.

Sa i përket çështjes së regjistrimit në Gjendjen Civile, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptan, kanë theksuar pamundësinë për t'u regjistruar kur ata janë vonuar me dënimet që Zyra e Gjendjes Civile i shqipton me rastin e vonesës në regjistrim. Në bazë të Nenit 34, par. 4, të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, kërkesa për regjistrimin e lindjes, në Gjendjen Civile, duhet të bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga momenti i lindjes dhe në raste të veçanta, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e lindjes. Vonesa në regjistrimin e paraqitjes së lindjes së fëmijës sipas këtij afati, dënohet me gjobë prej njëzet (20) deri pesëdhjetë (50) Euro.

GËZIMI I TË DREJTAVE NGA SKEMA E NDIHMAVE SOCIALE

Mungesa e regjistrimit në Gjendjen Civile, përbën njërin ndër problemet themelore me të cilin përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Mungesa e një regjistrimi të tillë, pamundëson dëshminë për prezantim para organeve që janë përgjegjëse për pranimin dhe bërjen pjesë të skemave të parapara me ligj.

Në bazë të Ligjit Nr. 2003/15, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, të gjithë anëtarët e familjes aplikuese duhet të jenë të pajisur me dokumente të Kosovës.

Rekomandimi 1

Qeveria e Kosovës së bashku me Kuvendin e Kosovës të nisin procedurat e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, respektivisht të Nenit 34, par. 4 dhe të Nenit 63, par. 1.1, me ç'rast ndryshimet do të rrisnin periudhën e regjistrimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe ndryshimi tjetër të prekë amnistinë në lidhje me gjobat për këta pjesëtarë të komuniteteve, për arsye të vonesës së tyre, me rastin e kërkesës për regjistrim të lindjes.

Rekomandimi 2

Anëtarët e këtyre komuniteteve janë në gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike. Mbi këtë arsye, ndryshimi i legjislacionit sekondar duhet të prekë edhe çështjet që lidhen me pagesën për dokumentacionin përkatës, letërnjoftimet tek çështja e zëvendësimit dhe pasaportat tek marrja e tyre për herë të parë. Kësisoj, i rekomandohet qeverisë dhe organeve të tjera që ndryshimet e bëra të heqin këtë barrë nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve për një periudhë të caktuar, në të cilën do të organizoheshin fushata vetëdijësuese dhe aktivitete ku synimi do të ishte që asnjë pjesëtar nga romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit të mos mbetet pas letërnjoftim.

Masat e tilla, nuk bien ndesh me Kushtetutën e Kosovës, ngase me Nenin 24, par. 3 të Kushteututës, thuhet se "parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla, do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".

QASJA NË ARSIM

Sipas Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 9, paragrafi 2, secili fëmijë me rastin e arritjes së moshës gjashtë (6) vjeçare duhet të fillojë shkollimin e detyruar, shkollim i cili ofrohet falas nga institucionet përgjegjëse lokale dhe qendrore.

Pavarësisht që me Ligjin për Arsimin Paraunversitar, shkollimi i detyruar i nxënësit/ve është përgjegjësi kryesore e prindit dhe se ky detyrim nëse nuk përmbushet atëherë ai bën shkelje të ligjit, tek rastet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, institucionet duhet t'i marrin për bazë edhe rrethant e tjera që e shkaktojnë këtë problem.

Rekomandim

Qeveria të ndërmarrë masa afirmative me qëllim që të promovohet barazia e plotë dhe efektive në të gjitha sferat e jetës ekonomike, politike dhe kulturore, duke përfshirë këtu arsimin. Institucionet qendrore dhe lokale t'i identifikojnë fëmijët e këtyre komuniteteve direkt në lokalitetet e tyre, për ta pasur të qartë dhe të saktë situatën mbi të cilën ndodhen realisht këta fëmijë.

QASJA NË PUNËSIM

Pjesëmarrësit e komuniteteve kanë shprehur shqetësim të lartë sa i përket nivelit të ulët të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve. Sipas tyre, kuotimi për punësim vazhdon të mos respektohet nga organet publike lokale dhe qendrore.

Rekomandim

Institucionet qendrore dhe lokale të zhvillojnë masa të veçanta, më tutje të zhvillojnë programe dhe iniciativa për punësimin publik të komuniteteve, krejt kjo me qëllim të zvogëlimit të hendekut dhe diskriminimit të drejpërdrejtë apo edhe të tërthortë të personave që iu përkasin komuniteteve në raport me komunitetin tjetër shumicë.

Për më tepër, me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe me Ligjin Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, institucionet publike obligohen që në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror, minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, do të jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë.

SHQYRTIMI I KËRKESAVE PRANË ORGANEVE PUBLIKE

Vonesat dhe moskthimi i përgjigjeve të institucioneve ndaj kërkesave të qytetarëve, përbën shkelje ligjore të Ligjit për Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike. Sipas këtij ligji, garantohet e drejta e secilit person, i padiskriminuar mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike.

Rekomandim

Agjencia për Informim dhe Privatësi, të ndërmarrë aktivitete përmes së cilave ua rikujton të gjitha institucioneve lokale dhe qendrore për t'u përgjigjur me kohë në pajtim me ligjin përkatës. Po ashtu, AIP të ndërmarrë aktivitete përmes së cilave, identifikon vetë rastet për shkelje të këtij ligji, kur bëhet fjalë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Infrastruktura në lokalitetet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbetet e dobët. Probleme të shumta për shkak të mungesës së ndriçimit publik dhe aty ku ekziston, është ndriçim i dobët. Më tutje, këto komunitete vazhdojnë të përballen me rrugë të dobëta, pa kanalizim adekuat dhe me deponi të mbeturinave afër vendbanimeve.

QASJA NË DREJTËSI

Vonesat në zgjidhjen e lëndëve nga pushteti lokal administrativ dhe nga ana e sistemit gjyqësor për çështjet që lidhen me pronat, mbetet njëri ndër problemet esenciale, me të cilin preken komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Rekomandim

Në kuadër të prioritizimit të zvogëlimit të lëndëve nga ana e sistemit gjyqësor në Kosovë, të bëhet përpjekje për ndërmarrjen e masave aktivite për zovgëlimin e lëndëve të vjetra të grumbulluara që i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Po ashtu, rekomandohet që në buxhetin për vitin 2023, të parashihet shumë më e lartë monetare për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në mënyrë që qasja në drejtësi të jetë e plotë për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, të cilët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në pamundësi të mjeteve financiare.

SHTOJCA:

Getjet për secilën komunë

Fushë Kosovë

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Fushë Kosovës.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 16 pjesëmarrës · 1 grua · 15 burra · 2 rom · 5 ashkali · 9 egjiptian

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Fushë Kosovës

Pjesëmarrësit në sesionin informues dhe trajnues shprehën shqetësimin lidhur me nivelin e ulët të punësimit të tyre. Ata janë shprehur të indinjuar se kuotimi për punësim nuk po respektohet për komunitetet e tyre në komunën e Fushë Kosovës. Nuk janë të punësuar nëpër institucione lokale e qendrore ashtu siç ju takon me kushtetutë e ligje përderisa pjesëtarë nga këto komunitete kanë profil të lartë universitar.

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas kërkuan që të analizohen statistikat e punësimit të përgjithshëm në komunën e Fushë Kosovës në mënyrë që të bëhet një analizë më e qartë sesi të veprohet tutje me integrimin e tyre në punësim.

Çështjet e infrastrukturës, si me ndriçimin publik dhe rrugë të dobëta, kanalizim si dhe deponia me mbeturina janë probleme që komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali e kanë në këtë qytet. Ata kanë adresuar ankesa në komunë dhe në institucione qendrore por që ankesat e tyre nuk janë shqyrtuar fare.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë shprehur indinjatën e tyre pasi fëmijët e tyre nëpër shkolla diskriminohen nga komuniteti shumicë si dhe nga vet mësimdhënësit, duke mos u siguruar fëmijëve të tyre edhe libra për të vijuar mësimin.

Një shqetësim tjetër i komuniteteve është edhe regjistrimi civil, ku shumë prej tyre kanë problem të pajisen me dokumentacion dhe për këtë kanë probleme dhe u pamundësohet edhe marrja e ndihmave sociale për ata që i plotësojnë kushtet.

Qasja në institucionet e drejtësisë është problematike dhe trajtimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve është ndryshe nga palët e tjera.

Prizren

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Prizrenit.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 11 pjesëmarrës · 3 gra · 8 burra · 8 rom · 2 ashkali · 1 egjiptian

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Prizrenit

Pjesëmarrësit konstatuan shumë probleme, me të cilat përballen ata në jetën e përditshme. Sipas tyre, regjistrimi civil mbetet sfidë e veçantë ku shumë fëmijë ende janë të paregjistruar dhe kjo shkakton shumë probleme në jetën e përditshme të këtyre komuniteteve. Këta fëmijë, e kanë të pamundur në faza të tjera regjistrimin për shkollim.

Nivel i ulët i ndjekjes së shkollimit deri në fund, konsiderohet ende si problem thelbësor në jetën arsimore.

Gjykatat vazhdojnë të kenë vonesa në zgjidhjen e lëndëve, veçanërisht tek nënat vetushqyese, të cilat pa vendim të gjykatës për besim të fëmijëve, nuk po arrijnë ta rregullojnë çështjen e ndihmës sociale.

Punësimi mbetet sfidë e veçantë. Qytetarët nga radhët e këtyre komuniteteve, kërkuan që të ndryshohet kuotimi për punësim, sepse në rastet kur lihet një kuotë e përbashkët për të gjitha komunitetet, atëherë ajo bën që pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të diskriminohen në raport me ata të komuniteteve të tjera joshumicë.

Sfidë mbetet edhe nevoja e përkrahjes më e madhe për strehimoren e grave dhe gjetja e vendbanimit të përhershëm për gratë viktima të dhunës në familje, sepse shumica e tyre kthehen prapë te dhunuesit, meqenëse s'kanë ku tjetër të qëndrojnë.

Po ashtu, analizimi i statistikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe në bazë të atyre të dhënave, të bëhet një analizë më e qartë sesi të veprohet tutje me integrimin e tyre në punësim.

Njohja e gjuhës rome si gjuhë në përdorim në Komunën e Prizrenit.

Ferizaj



Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Ferizajt.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 17 pjesëmarrës · 2 gra · 15 burra · 1 rom · 16 ashkali

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Ferizajt

Regjistrimi civil mbetet sfidë e veçantë, ku shumë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë të paregjistruar dhe kjo atyre iu shkakton probleme të shumta në jetën e përditshme.

Problem i theksuar vazhdon të jetë arsimimi për shkak të nivelit të ulët të personave që ndjekin shkollimin deri në fund, por veçanërisht për fëmijët e paregjistruar në regjistrat civil, mos-regjistrim i cili iu shkakton pamundësinë e regjistrimit në shkollat publike të kësaj komune.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptan, përballen me qasjen mospërfillëse të komunës në raport me përgjigjet në kërkesat e tyre. Përkundër faktit që kërkesat dërgohen dhe protokolohen, ata nuk marrin përgjigje.

Sfidë e veçantë për këto komunitete vazhdon të jetë çështja e punësimit. Ata shprehen se ka pjesëtarë të komuniteteve që mund të punojnë punë të ndryshme, por që nuk angazhohen nga komuna apo qeveria. Në këtë drejtim, ata veçanërisht janë ankuar në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj si dhe në Zyrën për Komunitete që nuk po bën mjaftueshëm në këtë drejtim.

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me legalizmin e pronave të tyre. Sipas tyre, qasja në institucionet e drejtësisë është problematike dhe trajtimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk është adekuat.

PEJË (sesioni 1)

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Pejës.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 6 pjesëmarrës · 6 burra · 1 rom · 5 egjiptian

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Pejës

Realizimi i të drejtave pronësore konsiderohet ende problem themelor i theksuar nga takimet informuese dhe trajnuese të organizuara nga IKD. Ata thonë se kanë prona, por për arsye të mosfunksionimit adekuat të sistemit të drejtësisë po u pamundësohet shfrytëzimi i tyre i lirshëm, respektivisht që ato t'i bartin në pronësi të tyre.

Diskriminimi në punësim, përmendet si problem i dytë pasi që sipas tyre një pjesë e këtyre komuniteteve kanë edukim përkatës, por nuk mund të punësohen. Të rëndësishëm e shohin faktin që institucionet duhet të respektojnë kuotën në punësim dhe për këtë çështje të marrin masa proaktive.

Diskriminim në shkollim, atyre u bëhet në raport me mundësinë që fëmijët e tyre të marrin shkollimin e duhur.

Çështjet që lidhen me ambientin mbesin temë e rëndësishme. Njëri tjetër problem që komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptan, e kanë përmendur, është deponia e mbeturinave, duke thënë se ata kanë bërë shumë ankesa në komunë dhe në organet e tjera kompetente, por që nuk është ndërmarrë asgjë, dhe kjo po ua vështirëson dhe rrezikon jetën e tyre, sidomos fëmijëve.

Ankesa kanë edhe në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm dhe me sistemin e kanalizimit.

Në raport me policinë, ata thonë se kanë ankesa në lidhje me procedimin e rasteve të tyre kur ato raportohen në polici, prokurori, etj. Sipas tyre, ata diskriminohen si komunitet dhe nuk marrin përgjigje nga këto organe ashtu siç u takon me ligj

Qasja në institucionet e drejtësisë vazhdon të mbetet problematike, përderisa trajtimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve vërehet që është ndryshe nga palët e tjera.

PRISHTINË

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Prishtinës.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 14 pjesëmarrës · 6 gra · 8 burra · 4 rom · 6 ashkali · 4 egjiptian

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Prishtinës

Pjesëmarrësit konstatuan shumë probleme, me të cilat përballen ata në jetën e përditshme. Sipas tyre, regjistrimi civil mbetet sfidë e veçantë ku shumë fëmijë ende janë të paregjistruar dhe kjo shkakton shumë probleme në jetën e përditshme të këtyre komuniteteve. Këtë fëmijë e kanë të pamundur në faza të tjera regjistrimin për shkollim.

Nivel i ulët i ndjekjes së shkollimit deri në fund, konsiderohet ende si problem thelbësor në jetën arsimore.

Gjykatat vazhdojnë të kenë vonesa në zgjidhjen e lëndëve, veçanërisht tek nënat vetushqyese, të cilat pa vendim të gjykatës për besim të fëmijëve, nuk po arrijnë ta rregullojnë çështjen e ndihmës sociale.

Punësimi mbetet sfidë e veçantë. Qytetarët nga radhët e këtyre komuniteteve kërkuan që ndryshohet kuotimi për punësim, sepse në rastet kur lihet një kuotë e përbashkët për të gjitha komunitetet, atëherë ajo bën që pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të diskriminohen në raport me ata të komuniteteve të tjera joshumicë.

Sfidë mbetet përkrahja më e madhe për strehimoren e grave dhe gjetje e vendbanimit të përhershëm për gratë viktima të dhunës në familje, sepse shumica e tyre kthehen prapë te dhunuesit meqenëse s'kanë ku tjetër të qëndrojnë.

Po ashtu, analizimi i statistikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe në bazë të atyre të dhënave, të bëhet një analizë më e qartë sesi të veprohet tutje me integrimin e tyre në punësim.

GJAKOVË

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Gjakovës.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 10 pjesëmarrës · 2 gra · 8 burra · 1 rom · 9 egjiptian

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Gjakovës

Pjesëmarrësit në sesionin informues dhe trajnues shprehën shqetësimin lidhur me nivelin e ulët të punësimit të tyre. Ata janë shprehur të indinjuar se kuotimi për punësim nuk po respektohet për komunitetet e tyre në Komunën e Gjakovës. Nuk janë të punësuar nëpër institucione lokale e qendrore, ashtu siç ju takon me Kushtetutë e ligje, përderisa pjesëtarë nga këto komunitete kanë profil të lartë universitar.

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptan, kërkuan që të analizohen statistikat e punësimit të përgjithshëm në Komunën e Gjakovës, në mënyrë që të bëhet një analizë më e qartë sesi të veprohet tutje me integrimin e tyre në punësim.

Çështjet e infrastrukturës, si me ndriçimin publik dhe rrugë të dobëta, kanalizim si dhe deponia me mbeturina, janë probleme që komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e kanë në këtë qytet. Ata kanë adresuar ankesa në komunë dhe në institucione qendrore, por që ankesat e tyre nuk janë shqyrtuar fare.

Sipas tyre, diskriminimi në Komunën e Gjakovës është i pranishëm. Ata ndihen të diskriminuar me praninë e tyre në lokalet e gastronomisë.

Një shqetësim tjetër i komuniteteve është edhe regjistrimi civil, ku shumë prej tyre kanë problem të pajisen me dokumentacion dhe për këtë kanë probleme dhe u pamundësohet edhe marrja e ndihmave sociale për ata që i plotësojnë kushtet.

Qasja në institucionet e drejtësisë është problematike dhe trajtimi i pjesëtarëve të këtyre komunitetevei është ndryshe nga palët e tjera.

KAMENICË

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Kamenicës.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 17 pjesëmarrës · 3 gra · 14 burra · 17 rom

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Kamenicës

Pjesëmarrësit në sesionin informues dhe trajnues shprehën shqetësimin lidhur me nivelin e ulët të punësimit të tyre. Ata janë shprehur të indinjuar se kuotimi për punësim nuk po respektohet për komunitetet e tyre në Komunën e Kamenicës. Nuk janë të punësuar nëpër institucione lokale e qendrore, ashtu siç ju takon me Kushtetutë e ligje, përderisa pjesëtarë nga këto komunitete kanë profil të lartë universitar. Në komunë kanë vetëm një të punësuar, po ashtu edhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kamenicë vetëm një pjesëtar, dhe diku tjetër asnjë.

Një shqetësim tjetër i komuniteteve është edhe regjistrimi civil, ku shumë prej tyre kanë problem të pajisen me dokumentacion dhe për këtë kanë probleme dhe u pamundësohet edhe marrja e ndihmave sociale për ata që i plotësojnë kushtet.

Pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me legalizmin e pronave të tyre.

Infrastruktura mbetet një shqetësim tjetër për ta. Sipas tyre, edhe pas kërkesave në komunë si dhe institucione tjera nuk marrin përgjigje adekuate për problemet e tyre dhe në këtë drejtim ndihen të diskriminuar.

Arsimimi është një tjetër problem në komunitet pasi nuk ka shumë pjesëtarë që ndjekin shkollimin pas atij që është i obligueshëm.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptan, në takimin informues dhe trajnues ka shprehur shqetësiminin lidhur me ndihmat sociale dhe realizimin e tyre.

GJILAN

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Gjilanit.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 14 pjesëmarrës · 1 gra · 13 burra · 13 rom · 1 ashkali

Takimi informues dhe trajnues në rajonin e Gjilanit

Pjesëmarrësit në sesionin informues dhe trajnues shprehën shqetësimin lidhur me nivelin e ulët të punësimit të tyre. Ata janë shprehur të indinjuar se kuotimi për punësim nuk po respektohet për komunitetet e tyre në Komunën e Gjilanit.

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptan, kërkuan që të analizohen statistikat e punësimit të përgjithshëm në Komunën e Gjilanit, në mënyrë që të bëhet një analizë më e qartë sesi të veprohet tutje me integrimin e tyre në punësim.

Sipas tyre, regjistrimi civil mbetet sfidë e veçantë, ku shumë fëmijë ende janë të paregjistruar dhe kjo shkakton shumë probleme në jetën e përditshme të këtyre komuniteteve. Këtë fëmijë e kanë të pamundur në faza të tjera regjistrimin për shkollim.

Një shqetësim tjetër i komuniteteve është edhe regjistrimi civil, ku shumë prej tyre kanë problem të pajisen me dokumentacion dhe për këtë kanë probleme dhe u pamundësohet edhe marrja e ndihmave sociale për ata që i plotësojnë kushtet.

Legalizimi i pronave të tyre është një tjetër shqetësim i shprehur gjatë sesionit informues dhe trajnues.

PEJË (sesioni 2)

Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Pejës.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 10 pjesëmarrës · 6 gra · 4 burra · 3 rom · 7 egjiptian

Takimi i dytë informues dhe trajnues në rajonin e Pejës

Realizimi i të drejtave pronësore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, konsiderohet ende problem themelor i theksuar nga takimet informuese dhe trajnuese të organizuara nga IKD. Ata thonë se kanë prona por për arsye të mosfunksionimit adekuat të sistemit të drejtësisë, po u pamundësohet shfrytëzimi i tyre i lirshëm, respektivisht që ato t'i bartin në pronësi të tyre.

Diskriminimi në punësim, përmendet si problem i dytë pasi që sipas tyre një pjesë e këtyre komuniteteve kanë edukim përkatës, por nuk mund të punësohen. Të rëndësishëm e shohin faktin që institucionet duhet të respektojnë kuotën në punësim dhe për këtë çështje të marrin masa proaktive.

Diskriminim në shkollim atyre u bëhet në raport me mundësinë që fëmijët e tyre të marrin shkollimin e duhur.

Çështjet që lidhen me ambientin mbesin temë e rëndësishme. Njëri ndër problemet që kanë përmendur komunitetet rom, ashkali dhe egjiptan, është deponia e mbeturinave, duke thënë se ata kanë bërë shumë ankesa në komunë dhe në organet e tjera kompetente, por që nuk është ndërmarrë asgjë, dhe kjo po ua vështirëson dhe rrezikon jetën e tyre, e sidomos fëmijëve.

Ankesa kanë edhe në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm dhe me sistemin e kanalizimit.

Në raport me policinë, ata thonë se kanë ankesa në lidhje me procedimin e rasteve të tyre kur ato raportohen në polici, prokurori etj. Sipas tyre, ata diskriminohen si komunitet dhe nuk marrin përgjigje nga këto organe, ashtu siç u takon me ligj.

Qasja në institucionet e drejtësisë vazhdon të mbetet problematike, përderisa trajtimi i pjesëtarëve të këtij komunite vërehet që është ndryshe nga palët e tjera.

Shqetësimet e tyre vazhdojnë në drejtim të realizimit të ndihmave sociale, pasi të njëjtit konsiderojnë se po diskriminohen nga komisionet përkatëse.

Obiliq



Gjatë muajit qershor Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi sesionin informues dhe trajnues me pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në rajonin e Obiliqit.

Trajnerët e IKD-së, kanë qenë të pranishëm në lokalitetet ku këto komunitete jetojnë.

· 13 pjesëmarrës · 4 gra · 9 burra · 10 rom · 2 serb · 1 shqiptar

Takimi i dytë informues dhe trajnues në rajonin e Obiliqit

Realizimi i të drejtave pronësore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, konsiderohet ende problem themelor i theksuar nga takimet informuese dhe trajnuese të organizuara nga IKD. Ata thonë se kanë prona por për arsye të mosfunksionimit adekuat të sistemit të drejtësisë, po u pamundësohet shfrytëzimi i tyre i lirshëm, respektivisht që ato t'i bartin në pronësi të tyre.

Diskriminimi në punësim, përmendet si problem i dytë pasi që sipas tyre një pjesë e këtyre komuniteteve kanë edukim përkatës, por nuk mund të punësohen. Të rëndësishëm e shohin faktin që institucionet duhet të respektojnë kuotën në punësim dhe për këtë çështje të marrin masa proaktive.

Diskriminim në shkollim atyre u bëhet në raport me mundësinë që fëmijët e tyre të marrin shkollimin e duhur.

Çështjet që lidhen me ambientin mbesin temë e rëndësishme. Njëri ndër problemet që kanë përmendur komunitetet rom, ashkali dhe egjiptan, është deponia e mbeturinave, duke thënë se ata kanë bërë shumë ankesa në komunë dhe në organet e tjera kompetente, por që nuk është ndërmarrë asgjë, dhe kjo po ua vështirëson dhe rrezikon jetën e tyre, e sidomos fëmijëve.

Ankesa kanë edhe në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm dhe me sistemin e kanalizimit.

Në raport me policinë, ata thonë se kanë ankesa në lidhje me procedimin e rasteve të tyre kur ato raportohen në polici, prokurori etj. Sipas tyre, ata diskriminohen si komunitet dhe nuk marrin përgjigje nga këto organe, ashtu siç u takon me ligj.

Qasja në institucionet e drejtësisë vazhdon të mbetet problematike, përderisa trajtimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteveomuniteti vërehet që është ndryshe nga palët e tjera.